

PASKAN ÇELUR MANUSHAQET...

Tepelenë moj buronjë

Moj Tepelena buronjë
që flori të rriti gjiri
djemtë si malet me borë
vashat trëndelinë prilli,

Sonte e dija do vinte
s'rrinte pa ardhur Selami
eja shpirtu Labërie
këngëbërë për se gjalli.

Margëlliç kala e sertë
që more Matohitin
ngrije që të vijë vetë
shpuzën të m'i ndezë shpirtit.

Lumi Vlorës atë ditë
Gjormi, Lepenica flakë
ku ta gjej, mu thanë sytë
Aba Shehun mal të lartë.

Mezhgoran e në një brinjë
atje tek ra Asimi
Kurvelesh s'e hoqe zinë
këngë bën dhe sot për birin.

Shtojzavalle që s'u trete
rritur me halle, e derte
na la pajën në sepete
bëhu nuse moj Nimete.

More Xheladin Beqiri
ajo nënë që të dha gjinë
prapë ta dërgoi te gjiri
dhe tek ti pi trimërinë?

Tepelenë moj zemërçik
që të ther zemra për djemtë
nga Janina do më vinë
doemos dhe bilbilenjtë.

Dhe t'ia marrin bashkë të tërë
këngës labe që s'shteron
ti je nënë, ne në rrënjë
tek ka rrjedhur dhe pikon.

Më ka marrë malli

Më ka marrë malli
të dal majë mali
të ulem në shtrungë
dhe të shkrep strallin.

Pa të ndizet eshka
aq erë të mirë
gjithë erën e Lufës
në maj e në prill.

Të dëgjoj thëllëzat
kur ia marrin këngës
në të zbardh të ditës
në të dalë të hënës.

Dhe të vë kopenë
përpara në shtrungë
e vedrat të mbushen
me qumësht e shkumë.

Një gjethe lëpjete
të merrja në dorë
një lugë e përvetshme
për shkumën si borë.

Kur të vinte darka
të haroja halle
dhe t'ia merrja shtruar
në mes të çobanëve.

Se dhe unë babanë
çoban e kam patur
sa herë mbi gjunjë
në stan më ka mbajtur.

I ikja nga gjunjët
rendja pas shelegëve
habitesha më shumë
me mjekrat e cjepërve.

U varnin në qafë
ca zile të rënda
pa kur tringëllinin
sikur ndizej kënga.

Ndaj dhe unë e dua
kaq shumë këngën labe
se është mjaltë mjalti
dhe mushkë xanxare.

Se e kam dëgjuar
tek e merrnin burrat
dhe nga ngazëllimi
fluturonin gunat.

Më ka marrë malli
të dal majë malit
të bëj gjumë shelegu
në një shark çobani.

Vargu në gjak më mbeti

Ç'ke moj zemra ime, ç'ke
ç'ke që dallgëzon si deti?
Mos gjithë këngët i the
dhe vargu në gjak të mbeti?

A mos vallë je inatosur
se gjithë këngët s'të mbinë?
Lulet e majit pasosur
s'janë të gjithë trëndelinë.

Ti i sheh që i kërkojnë
të gjithë këngët e tua
ca çobanët nëpër male
dhe ca vashëzat në krua.

Ndaj ti shkruaj përsëgjalli
shkruaj dertin, shkruaj hallin
shkruaj mallin, shkruaj zjarrin
se nga varri do t'i marrin.

Ç'ke moj zemra ime, ç'ke
ne të dy të njëjtët jemi
mos gjithë këngët i the
dhe kënga në gjak të mbeti?

Këputa një lule

Këputa një lule
që mezi e mbolla
si s'më dhëmbi gjiri
si nuk m'u tha dora.

Ç'më mbeti baçeja
më mbeti e qetë
ku ti hedhin sytë
ku ti hedhin djemtë.

Pa iku pranvera
iku dhe behari
erdhi vjeshtë e parë
më këputi malli.

Vjeshtë gjetherënë
vashat ku i shpie
mbi ballin si hënë
vello nusërie.

Pa u heqin vellon
djemtë si lastarë
kush nuk i provoi
ç'djallë si paska marrë.

Mbij moj manushaqe
mbij mos trëndelinë
për gushë e për faqe
do të jap rininë.

Paskan çelur manushaqet

Hajde të dalim në baçe
se erdhi pranvera
paskan çelur manushaqet
ardhur gjer tek dera.
Moj pranvera që shkrin borën
nxirra tek porta beronjën
ajo di e më pret kollën.
Paskan çelur erëshumë
gërxheve në pyje.
Mblidh një dorë siç dua unë

se na dalin të dyve.
Me ngadalë kur ti këputësh
s'janë rritur mirë.
Të bien nga cepi i futës
vriten e nuk mbijnë.
Mos u lodh që t'i bësh tufë
hidhi një nga një.
Në të mbetë ndonjë në gushë
lere ç'ke me të.
Në mbetë ndonjë në faqe
lëre mos e nga.
Për nishan një manushaqe
lumthi kush e mba.

Mustafa Matohitit

Të shkruaj më mori malli
të bëj për bilbilin këngë
Unë, ai dhe Margëlliçi
kemi shumë për të thënë.

E dija Muço do vije
buzagaz e dhëmbjeshumë
lis i lartë Labërie
ti me dert, un' i pagjumë.

Dhe do vinim nëpër stane
ku kish shkelur këmba jote
nëpër zjarre partizane
nga ku nisën flakë shqote.

Po ta hapim historinë
një për një, fletë më fletë
vitet e luftës do vinë
duan që të flasin vetë.

Unë do ti bëja këngë
të gjitha fjalët e tua
kur pikon gjakun në rrënjë
ke dhe kombit se ç'i thua.

Ka një këngë Kurveleshi
e këndon vetëm për ty
Bilbil Moço Matohiti
që s'të shoh me sy.

Avni Rustemit

Kohrat ikin, ti mbi kohë
flakadan që s'u venite
krahët more në shqiponjë
o djal i libohovite.

More udhëtim të rëndë
nëpër ditë, nëpër natë
s'dije që do ishte këngë
dije që do merrje hak.

Të rëndon koburja gjirin
plag'e zemrës dhëmb më shumë
nata s'e priste mëngjesin
dhe mëngjesi natën kurrë.

Tri krisma Parisin çanë
ngrihet Evropa në këmbë
-Ç'bëre Avni të thanë?
-Desh të më linin pa nënë.

Cili komb e kudo qoftë
që me nënën bën pazarin
kot e hedh farën në tokë
nuk mbin fara, pa ugarin.

Ai burrë që me dhe ti

Pa shi nuse dera ç'ka
është era, o mama
është'jarani, ç'ç më tha
më puthi s'u bë hata
lehtë-lehtë ca nga ca
një lule në gji më la
i thashë të pres'dhe pak
të më vijnë në krevat.

Ai burrë që më dhe
mot më mot plot tre sene
nuk bëri dot pëlle
ky jarani që kam tani
më shtrydh si limon në gji
plastë ai që më dhe ti.

Mbolla tingujt e një cule

Ndënja një nobet të tërë
një natë në një lëndinë
dolën yjet, doli hëna
vetëm mikja s'mu të vijë.

Gurgullimën e burimit
ma bie nata ngadalë
bien gjum'gjethet e pyllit
vesa bie përmbi bar.

Heshtja natës thyhet lehtë
dëgjohet një fëshfërimë
thash'u këput ndonjë fletë
çelën gjethet në prill.

Pa m'u shfaq si xixëllonjë
si ylberi mbrapa shtiu
vasha si lastonjë e njomë
zemra rreh më shpejt vetiu.

Fjalët më mbetën në grykë
edhe koha kishte mbetur
mbledhur gjithë bukuritë
dhe në shtat të vashës tretur.

I hodha dorën në qafë
fërgëlloi si thëllëzë
gjiri gati t'i pëlcase
syri si liman i gjerë.

Mori krahë e fluturoi
mjelmë e bardhë mbi valë
plagën që kesh më shëroi
s'qe shaka me atë plagë.

Dhe ashtu me mugëllirë
hap më hap lashë nga një lule
tek trëndelina në brinjë
mbolla tingujt e një cule.

Labëri me besë burri

Historia shpalos fletë
i shpalos palët flamuri
Labëri o djep i nderit
Labëri me besë burri.

Male të lartë në këmbë
një dorë dhe mbi shkëmbënjë
djepet rritin djem të rëndë
me hasmin dhëmbë më dhëmbë.

Dhe mbi male më je ngritur
herë e ëmbël, herë e sertë
e sertë, hasmin goditur
e ëmbël kur puth djemtë.

Pa, më sill moj nënë e mirë
gjithë dhimbjet, gjithë kështjellat
gjunjë më gjunjë të rrimë
të përndizen fustanellat.

flakadan në vite, shekuj
do jesh Labëria ime
unë yt bir edhe i vdekur
do të flasë me këngën time.

Dhe në mos pas'sha letër
unë i vdekur ku ta gjej?!
do marr krenarinë tënde
këngë labe do ta bëj.

Ku je rritur moj lastare

Ra një borë lartë në male
zbriti sorkadhja në lumë
qafëgjatë, nazemadhe
i la gjahtarët pa punë.

Më i riu në gjahtarë
tek një shteg zuri pusi
kur e pa u bë i marrë
i mbeti çiftja në sy.

Ku je rritur moj lastare
as më thua që ta di
ka të tjera në ato male
apo ishe vetëm ti?

Pse nuk vjen fllad i veriut
të më përkëdhelësh lehtë
unë faj s'i kam njeriut
ti në shteg më erdhe vetë.

Nuk më thua moj e mirë
për sa vite do të pres?
mos për mua qenka thënë
që të pres gjersa të vdes?

Të priste nëna me nuse "Piro Koninit"

Më erdhe tek dera
të prisja me nuse
ç'pate djal'i nënës
shpirtin më këpute.

Ç'pate Piro, ç'pate
Ç'pate asht i zemrës
të kisha e mjera
si dritën e hënës.

Ç'pate biro, ç'pate
që gjirin më thave
loti pikon rëndë
të rrita me halle.

Të rrita e mjera
m'u si pik'e pikës
të vranë tek dera
m'u në mes të ditës.

Si s'u kthye plumbi
të më merrte mua
ç'e do nëna jetën
pa fjalët e tua.

Lapidarit të dëshmorve Progonat

Përmbi këtë breg të bukur
pesë maja lapidari
lidhur me gjerdanë gjaku
mpiksur me lule behari.

Dhe shqijonja krahëhapur
brenge gjirit i mban ngrohtë
tokë e dhëmbshur e përgjakur
bij, o bijt e mi u thotë.

O ju vasha, deli vasha

Dola një ditë në sabah
lis i çarë ashëra
më nganë ca vashëza.

Po ku vete, o xhaxha
të luash me ne s'ta mba
kemi naze të mëdha.

Ku vete o lumëzi
pse s'mban plakën në shtëpi
ne kërkojmë djem të rinj.

Ne i duam djem beqar
ti je për të qarë hallë
s'të ke mbetur gjë pa tharë.

O ju vasha deli vasha
rënsha mbi ju e mos u vrafsha
të gjitha m'i bëtë hasha.

Po me mua ç'patët vallë
unë e di shkisni si ngjalë
vetullat m'i bëni halë

O ju gonxhe sapoçelë
që kërkonin djem beqar
shihni mësoni njëherë.

Mbiu një manushaqe

Aty tej në Vitoçakë
mbiu një lule s'u tha
një e bukur manushaqe
dhe të tjera s'ka.

Akoma pa çelur mirë
mars' i egër borë dha
rreth e rrotull s'kish të mirë
kishte halle të mëdha.

Po lulja petaleshtrirë
diellfshehurit i tha:
shkrije borën, ngroh më gjinë
ne fati kështu na la.

Do të jap erën e mirë
plastë zemra po s'ta dha
mirësin'që ka të tërë
shpirti im për ty e mba.

Dielljeta, diellzjarr
hapi retë, dheun përflakë
sot e mot e përtej varri
mos e thaj një manushaqe.

Moj unaza rreth floriri

Moj unaza rreth floriri
në më lësh të të puth gjirin
do të jap dritën e syrit
të jap këngën e bilbilit
gjithë zhurmërimat e burimit
lulen hënë të tërfilit
ujin e ftohtë të burimit
Moj unaza rreth floriri
po ç'u bë se u puth gjiri?

Brenda syrit një copë qiell

Kur më zbret nga shtegu i zallit
Leni moj, bijë e çobanit
më shkoje përpara stanit
marrosje mua të marrin.
Vetullat pres jatagani
inatin hanë me ballin
shushunjë lozin me diell
ai nishani në faqe
i vogël si pikë vese
brenda syrit një copë qiell
Iermë ta puthë se më plase.

Nderim Kosovë

Nderim Kosovë!
nga unë biri i Jugut
që në gjirin tënd piva trimërinë
në ballin tënd
si Shota të bukura
mbijetesën tënde kam pirë.

Nderim Kosovë!
rrënjërrënja e lirisë
që mjaltin e saj na mëkove
në zërin tënd
gjëmimi i historisë
në vikamën tënde që mbolle.

Nderim Kosovë!
Bijte, zogj shqiponje
përgjakur shekujsh nëpër suferinë
kur ti e mira
të vinin i kërkove
majmalesh në istikame mbinë.

Zotërinj mos heshtni!
Parlamentarë, kryeministra, presidentë
Kosova me gjak të ardhmen vulosi
Kosova flet vetë!

Nënë moj, e mira nënë

Udhë e largët më kish marrë
gji e zemër më kish çarë
nënë moj, e mira nënë.

Det i thellë e pamatur dhembshurie
sa më prite atë natë, ti e dije
Nënë moj, e mira nënë.

Era vjen e më thotë dy fjalë
Ulërinte si e marrë,
Nënë moj, e mira nënë.

Hajde të kalojmë malë
dhe s'më tha ç'më kishte ngjarë,
Nënë moj, e mira nënë.

Erdha s'të gjeta të gjallë
u ula të putha ballë,
Nënë moj, e mira nënë.

Të putha gjirin e tharë
po dot nuk ia nxora mallë,
Nënë moj, e mira nënë.

Më zhuriti malli

Më zhuriti malli
dhe të mbaj në sy
lotët i kuptoj
gjashtë vjet pa ty.

Dua të t'i puth
baluket e zeza
në gji tim t'i fut
të më vinte era.

Kur të vi në gjirin tënd

Zemra më lëngon e s'tretet
dhe gjiri mbudhur me plagë
shpirti në vargje më mbetet
i them del e s'do të dalë.

Po pse qënkam kështu unë
ç'ke o zot që nuk më thua?
Sytë nuk i mbyll për gjumë
s'bëj ç'më thonë, po bëj si dua.

Dil o shpirt e ndal o zemër
që të fle me këngën labe
vdekja të më duket ëndërr
këngët të më thonë hajde.

Kur të vinë për në varre
trupin tim nuk do ta gjejn
e kam shkrirë nëpër vargje
suferinës ia kamë lënë.

E di ç'do thuash për mua
kur të vi në gjirin tënd
se kështu më ke gatuar
herë fllad, herë shkëmb.

Këngë në çdo buzë djali

Pilur, o ballkon i detit
portë e maleve të thonë
këtë emër kush e gjeti
e pruri në kohën tonë?

Kush ka qënë në Vanovë
erën Jonit e ndjeu
gjirin hap ajo beronjë
dhe Lefteri penën ngjeu.

Ku i gjen këngët e tua
mor Lefter i pilurjote
në thëllëza, në bilbil
a në vetëtima shqote.

Derdhe nëpër ato këngë
zilet, këmborët e dhënve
sevdanë natës me hënë
derdhe mallin e të rënëve.

I dhe këngës erë baroti
i dhe ledhatime deti
i dhe zemër pilurjoti
ndaj këngë Lefteri mbeti.

Gjithë-gjithë ç'u kënduan
mbetën melodi longari
bejkë e bardhë, borë mali
mbiu në çdo buzë djali.

Moj kunadhia motake

Moj kunadhia motake
shkel e nuk zihe në çarqe
çarqet i shkrehe të tërë
çarku im do të zërë.

Vetullat e tua pëndë
që zili i ka palloi
të bëj gjumë nuk më lënë
flas me shushurimë kroi.

Flas bëhem si i lënë
si i dehur, si i marrë
bie e s'paskam të rënë
rënkam e s'paskam të vrarë.

U firokam pak nga pak
po ti ç'bën pse nuk më tha
kaq i sert qënka ky çark
sa i vret këmbët e tua?

Në qënka çarku i sertë
thujma që ta zbusë unë
ose më mirë hajde vetë
çarkun ta lëmë pa punë.

Dhe në ardhsh qoftë thënë
natën pa mëngjes do lëmë
zogjtë pa kërkuar këngë
vesën mbi lule pa rënë.

Ne të dy në atë vend

Dola një natë me ty
na zuri një vesë shi
ç'të bëja moj kulumbri
të thashë futmu në gji
futu në gji se u lage
të rrimë faqe më faqe
buzë më buzë të rrimë
pa të bjerë suferinë.
Po ti heshte nuk m fole
zgjate krahët më mbështolle
lehtë-lehtë u çanë retë
ne të dy në atë jetë.

Çeli trëndelina

Trëndelina çeli
se erdhi behari
merre udhën lart
se më dogji malli.

Hidhe hapin lehtë
hidhe si sorkadhe
mali është i sertë
zemra më ka halle.

Më shpure të mjerin
në njëqind burime
më the mos pi ujë
pi në buzën time.

Si flutur e bukur
më erdhe te stani
zogjtë lanë punët
cicërimat ndalin.

Thëllëzat u mblodhën
bashkë buzë lerës
i freskojnë këngët
me flladin e verës

Ti moj hënë, që dole mbrëmë

Ajo hënë që doli mbrëmë
seç kishte një gjë të rallë
herë dilte, ndriste vëndë
herë fshihej për të dalë.

Dhe ashtu me naze shumë
ulej e puthej me valë
i thot' valës të heq blunë
dritë argjendi të marrë.

Vala qesh me shkumë
ç'të gjeti kështu moj hënë
yjet s'do ta varin kurrë
blunë të të kishin dhënë.

U fsheh hëna mbrapa resë
nata valën e mbuloi
bluja u bë më e thellë
hëna pa dalë s'duroi.

Një behar e dy-tri hënë

Ndënë krua del e rri
hedh një grusht ujë në sy
kërkova me se ti fshi
mike mos ke një shami.

Në s'ke shami moj aman
lermë t'i fshij me futan
nuk pres dot të iki vera
vjeshta sjell halle të tjera
ata flokë palë-palë
se lënë ballin të dalë.

Syri yt ulli i zi
pse mbiu në sytë e mi
si t'ia bëj dhe unë se di
i them hajde-se lë ti.

Të dy bashkë e s'na lë kroi
shushurimën nuk shoi
nuk e di se si duroi
nuk e ftohu-po përvëloi.

Ndënë krua dal e rri
them me vete. . ç'nuk kam thënë
s'ishin netë a dy a tri
një behar a dy-tri hënë.

Nata mbeti e pagjumë

Ai djalë i asaj nate
Sa qeshur qimja në faqe
më mori në krahë e vate
s'priti më t'i thosha hajde.

Si veriu përkëdheli
udhën e malit të tërë
mali s'e ndjeu s'i erdhi
tendën gati e kish bërë.

Nata mbeti e pagjumë
dhe dita pa hapur sy
fajin nuk e kisha unë
po ç' faj pati dhe ai?

Malet borën kanë flakur

Bie një culë dyjare
pse me vaj e ulërimë
ditët si netë tinzare
mëngjeset plakën pa gdhirë

Malet borën kanë flakur
po pranvera s'do të vijë
rrënjë e lules është' përgjakur
rrënj' e jetës ështëë mpirë.

Retë qiellin e zunë
deti dallgët hedh përpjet
gjithë gjindja, ndarë në gjumë
fryrë sa s'mbajnë lumenjtë.

Flakët retë i lëpijnë
përzhitet vendi i tërë
ç'ështëë kështu moj nëne e mirë
dhe pa varre do na lënë ?

Thërmohet durim i kombit
si guri nga vetëtima
drithëron pala e flamurit
mbetet prehëri pa trima.

Zot'i madh kur e krijoi
këtë kombin ton'me vlera
i dha forca që mbijetoi
t'i japë dhe këtë herë.

Ule grykën e kallashit

Ej, çorapekokë!
ule grykën e kallashit
dorën në xhep mos fut
ka mbetur kutia e duhanit
në shpirt kam pasurinë
ku ke shpirt ti o i mjerë
shpirti i njeriut ështëë tek Zoti
shpirti sinjeriu. . . . dergjet në ferr.

Më vaditje manxuranën

Më vaditje maxuranën
hidhi, mos e lërë pa ujë
Delvinjote, pikë e djersës
të paska lezet mbi buzë.

Dielli sapo ka rënë
dhe vesa sa është therë
ti ç'ke që nuk lot me mua
po luan me manxuranën?

Pa ngrei sytë, pa ngrei
sytë ulli i porsa bërë
gjak e zemër, gjithë merri
merrmë dhe mua të tërë.

Udhëve nga vjata, shkova
sytë e tu më ndiqni pas
ktheja kokën i vështroja
hidhja hapin me avash.

Moj e mira Delvinjote
e shtrenjtë je, gjer në thua
sot nuk shkoka fjala jote
shkoka imja, keshtu dua.

Shumë kohë s'më ka mbetur
prapë do iki, delvinjote
unë e di që do më ndjekë
hap pas hapi, hija jote.

Dridhe eshkën si qiriri

U dogja eshkë i shkreti
më përvëlton kraharori
ç'është ky zjarr e mori dreqi
kush e ndezi, nga e mori?!

Ç'është ky zjarr, që nuk u ftohka
me ujë të akullt burimi
dhe pse erdhi s'më tregoka
mos është vallë vetëm imi?

Po pse djeg pastaj kaq shumë
vitet ikin, ai shtohet
Zot, i madh nuk paska punë
me mua do robëtohet?

E di që digjem si eshkë
eshka ka erë të mirë
kur mua të mos më kesh
ndize eshkën si qirinë.

Labëri ku linda unë

Moj thëllëz'e parë e prillit
dole në Gërzhun, në brinjë
trete vështirmin mbi male
s'ngopeshe me Labërinë.

Syri ri në Këndrevicë
majat festen me dëborë
shpatet larë trëndelinë
ku sheh më të bukur zonjë?

Këbusi si vash' e bukur
veshur fustanin me lule
njërën dorë mbi sup të Llufës
tjetrën Shurit Kuçe tutje.

Pa më dil në Bohotinë
shih Çipinin kryelartë
lumi Vlorës do të vijë
i përzhitur nëpër flakë.

I pëzhitur, i përflakur
i pagjunjur, i përgjakur
për shtizë bjaraku mbajtur.
rrënjë-rrënjë, zot te pragu.

Gjaku yt na mban në këmbë
Labëri moj mesgajtane
ndaj dhe djemtë nuk të lënë
se i ke rritur me halle.

Moj thëllëzë e parë e prillit
të m'i puthësh ato vende
kur për to më ndizet gjiri
çmallem dhe me këngën tënde.

Kurvelesh ç'i bëre djemtë

Trembëdhjet male në këmbë
trembëdhjetë Bilbilënjtë
varret mbetur në Janinë
nami vatur në Dovlet.

Kurvelesh ç'i bëre djemtë?

I rrite me halle shumë
pa rritur i bëre burra
me aromë trëndeline
me ujë pirë nga gura.

Shkelin sertë përmbi plumba.

Një emër trimi u vure
se trimat një emër kanë
nëpër kohë këtu i prure
kohët s'u hoqën litarrë.

Fol Bilbil Shakua një fjalë.

"Dale bej të dredh cigarë"
prit të hedh çepenë mbi ballë
prit të puth shokët me rradhë
prit të shoh një herë vatanë.

Për ta malli do më marrë.

Më thanë në ato male

Më thanë në ato male
një sorkadhe trëndelinë
majë shkëmbit hidhte valle
lante sytë në burime.

Binin pikëzat e ujit
mbi faqe të kuqe mollë
mbi gushën si të pëllumbit
dhe dukej si lule bore.

Mblidhte lule aq të mira
burbuqepsur rrëzë shkëmbi
përkëdhelej në lëndina
po një ditë se kush e trembi.

Mora udhën që ta gjeja
i brodha malet në këmbë
në krahë të vesës flija
nëpër ëndrra bëja këngë.

Më afrohej me ngadalë
sa shikonte ëndrrën time
pastaj ikte si e marrë
ikte-ikte prapë vinte.

Më thanë në ato male
një sorkadhe paskej qenë
s'ishin llafe, ishin halle
ajo dilte, s'dilte hënë.

Këputen yje të shuar

M'u thanë lotët, m'u terë
lot'i syrit m'u mbarua
zemra m'u bë pik e vrer
edhe pena nuk më shkruan.

Më kullon katran e sertë
ç'u bënë djemt' e vatanit
përtej deteve më mbenë
u këputi gjirin malli.

Ai mall që thërmon gurë
thërmoi lule rinie
bota s'kishte parë kurrë
kaq thërrime Shqipërie.

Udhëve Evropës plakë
meraku s'i lë të flenë
vallë do kthehen këtu prapë?
Nënë e babë do gjejnë?

Këputen yje të shuar
dhe zhuritën dashurinë
lënë vashat pamartuar
nuseve të zez'shaminë.

M'u thanë lotët, m'u terrë
kënga më paska mbarruar
pse kështu moj nënë e mjerë
buza jote pa gëzuar?!

Prehërin na kanë lënë

Tunden malet, detet ngrenë
Shqipëri moj kockë pallë
kohët mbi supe të lënë
plagë plumbi, ti po gjallë.

Tundje supet, plagët binin
po të tjerë mbinin prapë
ndizje ti zjarrin e shpirtit
për të rënë merrje hak.

T'u lëshuan si të marrë
të shkretuan, të gjymtuan
djepin donin për të tharë
këngët donin për të shuar.

Ëndërroja në shtrëngatë
në sofër bashkë të tërë
edhe sot Evropa plakë
vetëm prehërin na kanë lënë.

Xhamadani i përgjakur

Më rrjedhin vargjet nga gjiri
si guri që buron nga malli
vjen e më futet në këngë
vet' Selam xhamadanbardhi.

Shqiponja që ruan vëndë
kohët të flënë s'e lënë
sa herë ndizet istikami
me dyfek në sy Selami.

Vlorë gjëmimadhja Vlorë
deti dallgë, malet borë
djemtë e Labërisë shkojnë
nuk shkelin, fluturojnë.

Breshkaxhiu nga ta dinte
ç'rritin thëllëzat e malit
Selamët e salarive
në thinja dert'i vatanit.

More Selam i paplakur
jeta të shkoi në luftë
me xhamadanë të përgjakur
hyn në këngë me gjithë pushkë.

Kur orteqe Këndrevicë
zbresin të bëjnë hatanë
ngrihe si në ato vite
" O djema, sa kini xhanë"

Unë këngë bëj në Vlorë

Ç'më potis me atë dorë
maxuranë e trëndelinë
leri se duart t'u lodhën
borëbardha në lëndinë.

Vesë e bukur saporënë
mezi pret të zbardhë dita
kurrë me diellin s'është zënë
edhe pse e tret përdita.

Po ti vetëm për një fjalë
më more inat të zinë
ti sheh që un'jam djalë
i bëj pra lulet të mbjinë.

Në ke zemër, në ke ëndrra
në më do e në ke shpresë
ose hajde rri me mua
ose lermë që të vdes.

Dhe në s' ardhsh këtë pranverë
pranvera s'risht do vijë
sos u rritëm menjëherë
unë djalë, ti kërthinjë.

Ç'më potis me atë dorë
e bën për inatin tim
unë këngët bëj në Vlorë
tek ti treta dashurinë.

T'u përgjakën horizontet

Zemërdjegur, përvëluar
këmbëheshtur, gjakpikuar
barutndezur, halleheshtuar
helmëderdhur, dertngarkuar.

U përflake nënë e mirë
t'u përgjakën horizontet
pse kështu vitet dymijë
gjole gjaku mes Evropës?

Pse kështu me barkun tharë
arratisur e nxirosur
ç'kishin vallë për të ndarë
ne sa nisëm, kur e sosëm?

Pse kështu buzëpaqeshur
hapur syrin zgavëruar
dyfekun në faqe mbetur
varrin etërve harruar. . . .

Mbetsha ëndërr

Gjethe në vjeshtë u thafsha
të gjitha nëmat i marrsha
dhe nga varri në mos ardhsha
të përkédhelem me vasha.

Mbetsha si një shark i shkretë
të tallen të gjithë djemtë
po s'u fola me lezet
sa ti uth e sa ti prek.

Mbetsha si cfakë në brinjë
miq e shokë të mos më vinë
po s'loz me gushën dhe synë
s'u mbush gjirin trëndelinë.

Mbetsha këngë, ëndërr mbetsha
t'u vete natën në gjumë
të më thonë bëna vjersha
un' t'i përkëdhel në buzë.

Ç'u bë dashuria ime

Dola në sofa në portë
të vadisja borzilok
jo me ujë por me lot
ligjet nuk i turrja dot
përplasej loti në buzë
dhe buza bënte ashra
mos pushofshin lotët kurrë
derisa timzot e pafsha.
Ah mor loti ujë deti
sa burra treti kurbeti?
aq sa vatanit i mbeti
në këngë dhimbja e derti
dhe e lag me lot çdo fjalë
Ç'u bë dashuria ime?
mbeti në qerpik pa therë.

Shkoi një zogë e pikur

Dita më të ikur
nata më të marrë
shkon një zogë e pikur
borë e qumësht e larë.

Muzgu sa ka rënë
hëna nxjerrë synë
sa nisur një këngë
me zë të bilbilit.

Një këngë sa nisur
një culë në buzë
zogjtë si të krisur
nuk rënkan në gjumë.

Eja natë behari
ç'qënka kaq e ëmbël
buza ftohka zjarrin
zjarri ndezka zemrën.

Nata më të ikur
hëna më të ngrënë
shkon një zogë e pikur
s'më la gjë pa thënë.

Nuk e dimë ç'është malli

Pa hajde vashë, pa hajde
të lozim bashkë një herë
ti sa çelur manushaqe
unë sa nisur të marr erë.

Pa hajde moj njomëzake
ne të dy s'jemi mësuar
s'dimë ç'janë buzë e faqe
s'dimë ç'është' të dashuruar.

Nuk e dimë ç'është malli
ç'është burimi në vapë
nuk e dimë ç'është zjarri
që të djeg e s'ndizet prapë.

Po ti hajde, vetëm hajde
jeta na ka hapur gjinë
kulprat lisin si maraqe
i ngjitet frymë më frymë.

Dhe ashtu në jetë të tërë
përqafuar, përvëlur
lisi rrënjë, ajo në rrënjë
njëri-tjetrin përgjërur.

Një dyfek se ku ra

Një dyfek se ku ra
mbrapa bregut e s'u pa
qe vërtet a qe shaka
kë plagosi nuk e tha.

Kë plagose mor i shkretë
këputi plumbi një degë
u hodh sorkadhja përpjetë
e bukur xhindja vetë.

E bukur e shtatë nure
doli si një zonjë nga pylli
këmba majë thoi ulej
thoin e puthte tërfili.

Dhe zbriti në një lëndinë
mbushur plot me manushaqe
mblodhi aq sa mbushi gjinë
dhe i tha një dreri, hajde.

Zuri t'i bënte kurorë
bëri tutje nga burimi
lulet s'kishin më aromë
aromën e kishte gjiri.

Deh aroma gjithë ç'janë
e ç'tju them a unë i ziu
ngre të vdekur, vdes të gjallë
ndaj digjet si prush vetiu.

Një dyfek se ku ra
s'ishte dyfek për të vrarë
kot e thash që nuk u pa
kush kish betur pa më parë.

Prek gërshetin ne burim

Në lëndina ku shkrin bora
dhe bari zë buis
vjen e shkon vetullaholla
me gërshetin përmbi sisë.

Vjen e shkon mu si një flutur
edhe syrin më rrëmben
hëna pas malit këputur
dhe sabahu portën gjen.

Veshi malet zbardhëllimë
zogjtë e pyllit nisën lodrën
në fole të vjetër vinë
thëllëzat që lanë borën.

Vesë e natës pikë argjëndi
puth gonxhen që sa ka çelë
fladit i lehtë majë shkëmbi
përkëdhel një luleshqerë.

Sythet gjethet i shpërthenjë
edhe mali zë bleron
një bilbil degë më degë
thotë një këng' që të shëron.

Thot' një këngë merakshumë
si sevdaja e gjirit tim
ulet vasha e pi ujë
prek gërsheti në burim.

Zgjata dorën dhe e ngrita
bishti gërshetit që lagur
ktheva kokën u habita
dhe burimi ishte pakur.

Kish pakur ujët burimi
vasha syrin e kish tretur
gjirin ndizte përvëlimi
gërsheti në dor' i lagur.

Buzët deshën që të flisnin
kërkuan e s'gjetën fjalë
të pafajshme mërmërisnin
digjeshin s'kishin të tharë.

Digjeshin të tharë s'kishin
s'thahet buza e dashuruar
platur gjak e dalë mishi
po pa puthur nuk duruan.

Gjethet shtuan fëshfërimën
edhe zogjtë këngët shtuan
buzët lanë përshtërimën
ç'bënë nuk ma thanë mua.

Ai syri yt behar

Mike më bëre merak
që s'më erdhe atë natë
i mjeri të prita gjatë
sa më plasi buza gjak.

Ajo hëna dritë argjendi
gjith'gushën të kishte zënë
një çik vënd të kishte lënë
sa buzën të kisha vënë.

Ai syri yt behar
në det, e në qiell larë
njëmijë jetë i kisha falë
brenda tij të më kish marrë.

Atë flokun tënd mëndafsh
ç'e hedh ashtu moj më qafsh
ç'e hedh ashtu onderëndë
valët e detit ke vënë?

Valët derdhur trëndelinë
kurorë ballit të rrinë
e hedh flladi, prapë vinë
më përvëllove të zinë.

Tek bajamja në avlli

Tek bajamja në avlli
u ula ndënja të rri
prita sa të shkoje ti
të të rrëmbeja me sy.

Dhe ti shkove rëndë-rëndë
nëpër buzë thoshte këngë
unë shihja buzët e tua
m'u duk këndoje për mua.

Nuk m'u duk ishte vërtetë
ç'më thoshe me këngë vallë
era fryn lehtë-lehtë
të hedh baluket mbi ballë.

Erë e lehtë të kam thënë
të mos luash me baluke
unë syrin sa kam vënë
ti më thua hiqe tutje.

Një gonxhe çelur nga vesa
pret që ta këput një djalë
një qerpik njomur nga djersa
pret vështrimin për ta tharë.

Ku janë këngët

Ku janë këngët, ku janë
ato këngët lozonjare
i këndonin që me natë
bilbilët nëpër dritare.

Ngriheshin vashat nga gjumi
hapin cepin e perdes
frynte lehtë erë e lumit
zgjonte lulet e baçesë.

Shkelnin vashat përmbi vesë
vurgullonte bari prapë
kush nga ju nuk më zë besë
plak ka lindur un' i them.

Ato supe njomështirë
zbrit më poshtë, zbrit o këngë
gjirit erë trëndelinë
të hedh syrin nuk më lënë.

Dielli sabahun thyen
dal e ulem në lëndinë
këngët në vite më shpien
prap' më bien djalërinë.

Cula derdhi meloditë
kaq të ëmbla ku i gjeta
pak burojnë nga gjiri yt
si nektari që mbledh bleta.

Shekulli nuk qenka plakur poem

O dhimbje që mbuluar
pa sosur vendin tim.

O këngë që pushuar
e morët rrokullinë.

O varre që shtuar
e tretët djalërinë.

O lot që shteruar
e dot se njomi synë.

O flakë që përvëluar
gjithë ç'kishim mbjellë.

O plumba desh mbaruar
gjithë ç'kishim pjellë.

O djepe që harruar
si tundeshin njëherë.

O nëna përgjëruar
o baballarë të mjerë.

O motra rrobazeza
që prisnit nusërinë.

O nuse ëndërrshuara
që prisnit fëmijinë.

O lule të paçelura
o erë e suferinë.

O gjëmime të shkrepara
stuhi e vetëtimë. . . .

Të gjithë, të gjithë
mblidhuni në vargje.

Pranvera që erdhi
s'pruri manushaqe.

Pruri krisma pushkësh
pruri rrëke gjaku.

Thau zemra nënash
mbylli dyer pragu.

S'frynte erë mali
frynte erë baruti.

Rrinte sus i drejti
gjukonte hajduti.

Dridhej parlamenti
m'u si zhapik gushti.

Rrënkonte mileti
fitonte hajduti.

.....

Thith cigarin, sa djeg buzën
thellohen rrudhat e ballit
Vlorë për ku more udhën
nga shesh'i rëndë i Qemalit.

Për ku more udhën vallë
për në majtë historisë
u skuqën ata pazarë
nga gjaku i rinisë.

Vlorë, Vlorë e jona vlorë
të kërkoi djalëria
të marrësh flamur në dorë
se na iku Shqipëria.

Deti dallgët nëntë ballë
mbërthen vetullat Çipini
hodhi sytë mbi Sarandë
O Tepelenas ku jini?

Dërgoi Shkodra haberë
pritna Vlorë se arrimë
do puthim dhe Myzeqenë
që e dogjën e zhurinë.

Pritna moj zonjë flamuri
kryekënga si përherë
ka lezet dyfek'i burrit
kur e merr për mëmëdhenë.

Foli Korça me Mirditë
edhe Lezha me Delvinë
kalin mbaj zotni një çikë
s'e ke çiflik Shqipërinë.

Dridhet Ndre Mjeda te varri
"Geg e Toskë një asht Shqipnia"
një grup gjaku ka vatani
një grup gjaku dhe liria.

.....

Marsi s'do të dalë
Prilli s'do të hyjë
lulet nisën vajnë
valët ulërimë.

Këngët kanë pushuar
kujt i vete mëndja
varret janë shtuar

lotët shtoi nëna.

Çobanët i hoqën
zile e këmborë
sherqet hodhën supit
dhe zbritën në Vlorë.

Qafës së Koçiu
zbresin symbërthyer
syri i Sazanit
qënka murrëtyer.

Syri i Sazanit
s'paska fjetur gjumë
lotët nën gulçinë
sheh Karaburunë.

Mësuar me gjëmë
Çobanët e panë
Labet drithëruan
dhe ca ligje thanë. . . .

O det i egër me valë
si duron nuk u thave
po i more nëpër natë
Melaqetë me sorkadhe.

Si duron mor i sertë
pse s'u trete, pse s'u ndave
dallgët të m'i bëje fletë
mbi fletë jetën ta mbaje

Tetëdhjetepesë qenë
tetëdhjetepesë gjëmë
s'kish Titaniku folenë
folenë e t'ij na bënë.

Ato nëna rrënjëdala
s'patën kohë të derdhnin lot'
se i mori brënda vala
gjirin nuk e thanë dot.

Pikoi qumështi i jetës
përzier me ujë deti
deti mori ngjyrë tjetër
qumështi detin e treti.

O det i natës së thellë
o natë marsi pa hënë
helmove derë më derë
moj Otranto marsh nëmë.

Bij o bij e gjak i zemrës
nuse yll e mbesa shpirt
nipër si zogu thëllëzë
ejani t'ju puth një çikë.

Vinë shokët, miqtë vinë
hapur portat kat e kat
përmbi Vlorë ulërimë
gjysëm shtize në bajrak.

Nuk pushoka lot'i kombit
dridhet dhimbjesh kontinenti
mbushet lutje fron i Zotit
bjeri: Zot t'i tret djepi.

U kujtove më së fundi

u kujtove moj Evrope
shekulli më të gremisur
pudra rrudhat s'ia fsheh dot

Shekulli u gdhi me luftë
pse u err me krisma prapë
nuk i doli djalëria
dhe tani që është plak!

Nuk i doli gjysmë e vendit
që e la jashtë kufiri?
ti shkërmoqeshe sallonesh
Shqipës i këputej gjiri.

Ti na ke kaç shumë borxhe
sa një jetë nuk i lanë dot
mos harro shekujt e shkuar
vetëm ne të dolëm zot.

Thyente hordhi Turqie
kryetrimi Skënderbe
ti këmbë mbi këmbë rrije
për ty firoheshim ne.

Një krismë pushke
këngët mi preu.

Një jetë tjetër
në mes u këput.

Era e barutit
vargjet m'i ngjeu.

Era e beharit
në gji m'u fut.

Një pëllumb i bardhë
çukit në dritare.

Një pëllumb i bardhë
i bardhë si ai.

Boll më me krisma
u ngopëm me varre.

Qetoje shpirtin
rilind Shqipëri.

Në djepe.
gonxhe të reja të çelin.

Të puthim Nënë
mëritë ti lëmë.

Për brezat të biem pranverën.

Prill 1997.